

REGIONE VENETO
ASSESSORATO ALLE POLITICHE SANITARIE
DIREZIONE REGIONALE PER LA PREVENZIONE

VAKSINIMI I FEMIJEVE
LE VACCINAZIONI NELL'INFANZIA

Vaksinimet janë një nga arritjet më të rëndësishme të mjekësisë dhe në sajë të tyre shumë sëmundje infektive të rënda dhe vdekjeprurëse sot janë nën kontroll dhe nuk arrijnë të bëhen të rrezikshme.

Vaksinimet janë një mënyrë e thjeshtë, e efektshme dhe e sigurtë për të mbrojtur fëmijet kundër sëmundjeve të rrezikshme për të cilat nuk ekziston ndonjë terapi e efektshme ose sëmundjeve që mund të jenë shkak i komplikacioneve të rënda. Rreziqet e këtyre sëmundjeve janë shumë më të mëdha sesa rreziqet shumë më të rralla që mund të vijnë nga berja e vaksinave.

Vaksinimi i fëmijëve do të thotë gjithashtu pjesëmarrje në aksionin e nxitur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë që ka për qëllim të mbrojë shëndetin e fëmijëve të të gjitha vendeve dhe të bashkëpunojë për arritjen e objektivave të tilla si zhdukja e poliomielitit dhe fruthit në bote.

Personeli mjekësor që vepron në shërbimet shëndetësore të Rajonit të Veneto-s dhe Mjekët Pediatric të Familjes janë prej kohësh të mobilizuar seriozisht për të bërë të mundur që të gjithë fëmijëve t'u garantohet mbrojtja me anë të vaksinimeve.

Pjesëmarrja e lartë në vaksinimet e fëmijëve të Veneto-s janë një vlerësim i lartë për këto aktivitete promovimi dhe tregojnë besimin e njerezve tane për këto mjete themelore të parandalimit të sëmundjeve.

Qëllimi i kësaj broshure është të japë informacionet e nevojshme mbi vaksinimet e fëmijëve dhe mbi sëmundjet që këto vakcina parandalojnë në mënyrë që vaksinimi i fëmijëve të jetë një veprim vertetë i ndergjegjeshëm.

Kërkesa për të ditur sa më shumë për vaksinimet është një e drejtë themelore dhe gjithashtu përben një mundësi të madhe për të përmirësuar cilësinë dhe efektshmërinë e shërbimeve të vaksinimit.

Ju ftojme të lexoni me vëmendje këtë broshurë dhe ta konsideroni këtë si një mjet të parë informimi; personeli i shërbimeve të vaksinimit dhe mjeku juaj Pediatric i Familjes janë gjithmone në dispozicionin tuaj për të thelluar çështjet dhe për të sqaruar çdo paqartësi.

Prill 2006

L'Assessore alle Politiche Sanitarie
Flavio Tosi

Permbledhje

| | |
|---|------|
| Hyrje | faqe |
| Kalendari Rajonal i Veneto-s per vaksinimet | faqe |
| Vaksinimi kunder Poliomielitit | faqe |
| Vaksinimi kunder Difteritit dhe Tetanozit | faqe |
| Vaksinimi kunder Hepatitit B | faqe |
| Vaksinimi kunder Kolles se Mire | faqe |
| Vaksinimi kunder Infeksionit nga Haemophilus Influenzae i tipit b | faqe |
| Plani Kombetar per zhdukjen e Fruthit dhe te Rubeoles se lindur | faqe |
| Vaksinimi "i trefishte" kunder Fruthit, Rubeoles dhe Shytave | faqe |
| Vaksinimi kunder Fruthit | faqe |
| Vaksinimi kunder Rubeoles | faqe |
| Vaksinimi kunder Shytave | faqe |
| Vaksinimi kunder infeksionit nga pneumokoku | faqe |
| Vaksinimi kunder infeksionit nga meningokoku | faqe |
| Vaksinimi kunder Lise se dhenve | faqe |
| Disa keshilla te vlefshme... ne rast se mbas vaksinimi | faqe |

HYRJE

Vaksinimi është një nga fitoret më të mëdha të mjekësisë. Nganjehere dëshirojme të dime më shumë për 'to veçanërisht kur na vjen ftesa për vaksinimet e para të fëmijës tone.

**Per te ditur me
shume**

Vaksinat janë të ndryshme sipas sëmundjes që kërkojnë të luftojmë. Ato mund të përbehen nga mikroorganizma të çaktivizuar (të vrarë) ose të zbutur (të bërë të padëmshëm), ose nga pjesë të tyre, ose madje nga substanca që ato prodhojnë, të cilat quhen toksina, e të bërë jo aktive.

**Cfare permbajne
vaksinat**

Vaksinat veprojnë duke nxitur një sistem natyral mbrojtjeje: sistemin imunitar. Ky sistem ka për qëllim të prodhojë antikorpe dhe qeliza mbrojtëse të cilat janë të afta të pengojnë shfaqjen e sëmundjes. Gjate jetës në na duhet të mbrohemi nga mijra virus dhe bakterie me të cilat ndeshemi sepse ata janë të pranishëm anëmbanë në ambientin që na rrethon.

**Si veprojne
vaksinat**

Vaksinat luftojnë sëmundje infektive të rrezikshme për të cilat nuk ekziston ndonjë terapi (poliomieliti) ose për të cilat terapia nuk është gjithmone e efektshme (difteriti, tetanozi, meningjiti nga hemofili, nga meningokoku, sëmundjet pushtuese të shkaktuara nga pneumokoku, hepatiti B, lëza e dhëmbëve) ose sëmundje të cilat mund të jenë shkak komplikacionesh të rënda (fruthi, kolla e mirë, rubeola).

**Cfare semundjesh
luftojne**

Në mënyrë që prinderit të jenë të ndërgjegjshëm për vaksinimet që duhet t'u bëjnë fëmijëve të tyre është mirë të kërkojnë informacion dhe sqarime tek qendra e vaksinimit ose te pediatri i besuar. Përpara kryerjes së vaksinimit personeli sanitar i shërbimit të vaksinimit verifikon që të mos ekzistojnë kundërkeshillime dhe kontrollon dokumentat sanitare të fëmijës (librezën shëndetësore personale, etj). Prinderit ftohen t'u bëjnë të ditur shërbimit vaksinal ose pediatri të besuar çdo dyshim ose konstatim që mendojnë se është i vlefshëm.

**Perpara kryerjes se
vaksinimit**

Vaksinimi shtyhet per me vone ne rast semundjeje akute me ethe ose me shenja te pergjitheshme qe konsiderohen te rëndesishme dhe ne rast se personi qe eshte per t'u vaksinuar ka marre kohet e fundit imunoglobuline (vetem per vaksinat e gjalla). Semundje te lehta te zakonshme (rrufe, diarre, infektion i pjeseve te sipërme te rrugëve te frymemarrjes) nuk perbejne shkak per te shtyre vaksinimin.

Kur shtyhet vaksinimi

Mbas vaksinimit, ne disa raste, mund te kete shfaqje lokale si enjtje, skuqje dhe dhembje, te cilat mund te mjekohen thjesht me kompresa me copa te lagura te ftohta. Nganjehere mund te shfaqet temperature, qe, ne qoftese mbi 38.5°C e matur ne zorren e trashe, kurohet thjesht me ilaçe kunder temperatures. Akoma me rralle, mbas vaksinimit mund te kete shfaqje te tjera te padeshirueshme. Per çfardo nga keto shfaqje rekomandohet te njoftohet menjehere mjeku pediater dhe/ose sherbimi vaksinor per trajtimin me te pershtatshem.

Mbas vaksinimit

Vaksinimi eshte nje eprim mjeksor parandalues i sigurte dhe i efektshem dhe praktikohet ne te gjithe boten gjithashtu ne saje te organizatave humanitare si UNICEF, Mjete pa Kufi, e shume te tjera. Me kete veprimtari disa semundje jane nen kontroll dhe te tjera se shpejti do te dobesohen. Nje perfshirje e larte ne vaksinimin e popullsisë se femijeve ben qe te pakesohet qarkullimi i agjenteve infektive, dhe, si rezultat, mbron edhe ata pak persona qe, per arsye te ndryshme, nuk jane vaksinuar.

Eshte e rëndesishme te dihet se

Siç ka ndodhur me semundjen e lise, parashikohet qe edhe poliomieliti do te eliminohet ne te gjithe boten brenda pak viteve. Qe nga ai moment nuk do te jete me i nevojshem vaksinimi kunder poliomielitit. Ne Itali, ne nentor 2003, eshte aprovuar "Plani kombetar per eliminimin e fruthit dhe rubeoles se lindur". Objektivat e Planit Kombetar jane: te arrihet dhe te ruhet eliminimi i fruthit ne nivel kombetar, duke i nderprere atij transmetimin lokal, dhe te pakesohen rastet e rubeoles se lindur ne me pak se 1 ne 100,000 te lindur te gjalle dhe te ruhen keto nivele. Per çdo vaksine qe nuk do te jete me e nevojshme urojme te mundemi te sigurojme te tjera per semundje te perhapura e te renda qe sot akoma nuk kontrollohen.

Dhe per te ardhmen?

Regione del Veneto

KALENDARI I VAKSINIMEVE PER MOSHEN E ZHVILLIMIT NE VENETO

Calendario delle vaccinazioni per l'età evolutiva del Veneto

| Vaksina | Lindje | Muaji i 3-te | Muaji i 5-te | Muaji i 13-te | Muaji i 14-te | Muaji i 15-te | 6 vjeç | 12 vjeç | 15 vjeç |
|------------------|-----------------|------------------|------------------|------------------|------------------------|------------------|-------------------|------------------------|---------|
| DTP | | DTaP | DTaP | DTaP | | | DTaP | | dTap |
| IPV | | IPV | IPV | IPV | | | IPV | | |
| Hepatiti B | HB ² | HB | HB | HB | | | | | |
| Hib | | Hib | Hib | Hib | | | | | |
| MPR | | | | | MPR1 ⁴ | | MPR2 ⁵ | | |
| PCV | | PCV ³ | PCV ³ | | | PCV ³ | | | |
| Men C | | | | Men C | | | | | Men C |
| Lija e dhenve | | | | | Lija e Dhenve 6a | | | Lija e Dhenve 6b | |

Legjenda

Dtap: vaksina kunder difteritit, tetanozit, kolles se mire joqelizore;

IPV: vaksina kunder poliomielitit e çaktivizuar;

Hib: vaksina kunder infeksioneve pushtuese nga Haemophilus influenzae b;

PCV: Vaksina kunder pneumokokut conjugato shtate-valente;

Men C: vaksina kunder meningokokut C conjugato;

HB: vaksina kunder hepatitit B;

MPR: vaksina kunder fruthit, shytave, rubeoles;

dTap: vaksina kunder difteritit, tetanozit, kolles se mire per te rriturit.

Kalendaret, vaksinat, mosha e kryerjes se vaksinimeve jane studjuar me qellim qe ky aktivitet parandalues te jete i thjeshte dhe i efektshem per sigurimin e mbrojtjes se shendetit te femijeve tane. Gjithnje e me shume vaksinat ofrohen ne forma te kombinuara ne menyre qe te pakesohet numuri i injeksioneve. Diferenca te vogla ne periudhat e kohes se kryerjes se vaksinimeve nuk influencojne ne vlefshmerine e vaksinimeve; por, vonesa ne fillimin dhe perfundimin e vaksinimeve ben qe te zgjatet periudha e kohes gjate te ciles femija nuk eshte i mbrojtur ne menyre te efektshme ndaj ketyre semundjeve. Per femijet e lindur para kohe ose me peshe lindjeje te vogel kalendari dhe kohet e vaksinimeve nuk duhet te ndryshohen, me perjashtim te rasteve shume te veçanta (p.sh. kryerja e vaksines se hepatiti B ne femijet me peshe me te vogel se 2000 gr).

Vaksinimi kunder **poliomielitit**

Vaccinazione contro poliomielite

Cfare eshte poliomieliti?

Che cos'è la poliomielite?

Poliomieliti eshte nje semundje infektive e shkaktuar nga tre tipa te ndryshem virusesh te cilet hyjne ne organizem kryesisht nepemjet aparatit tretes. Eshte fjala per nje semundje shume te rrezikshme,ngaqe,ne rastet me te renda,mund te shkaktoje paraliza te pakthyeshme, kryesisht te gjymtyreve, dhe, nganjehere edhe vdekje. Fatkeqesisht nuk ka ilaçe qe mund te kurojne kete semundje ne qoftese ajo eshte zhvilluar; e vetmja mundesi konkrete per te evituar keto pasoja te renda per shendetin eshte parandalimi me ane te vaksinimit.

Ne Itali, perpara se te aplikohet vaksinimi (ligj i vitit 1966), pati mese 6.000 raste poliomieliti ne 1958 dhe rreth 3.000 raste ne vit ne periudhen e viteve '60; rasti i fundit eshte regjistruar ne vitin 1983.

Vaksinimi ne mase ka mundur te eliminoje poliomielitin ne pjesen me te madhe te vendeve te botes,por ne disa vende ne zhvillim semundja eshte akoma e pranishme. Perderisa poliomieliti te mos jete mposhtur ne te gjithe boten, ekziston gjithmone rreziku qe ky virus te hyje perseri ne vendin tone.

Per kete arsye eshte e rendesishme te vazhdohet te mbrohen femijet me ane te vaksinimit kunder poliomielitit.

Vaksina kunder poliomielitit

Il vaccino contro la poliomielite

Vaksina kunder poliomielitit (i quajtur eshe "Salk" ose IPV) permban viruset e poliomielitit te vrare (te çaktivizuar) dhe jepet me nje injeksion brendamuskulor ose nen lekure. Cikli i plote i vaksinimit kunder poliomielitit parashikon marrjen e 4 dozave.

Kjo vaksine (e fuqizuar, potenziato) eshte me e efektshme se sa formula origjinale. Vaksina gjendet ne formule te veçante ose ne kombinime te ndryshme me vaksina te tjera.

Vaksina qe perdorej me pare dhe qe permbante virus te gjalle te zbutur, e quajtur Sabin, eshte nxjerre nga perdorimi perfundimisht dhe eshte zevendesuar nga vaksina e çaktivizuar e fuqizuar shume e efektshme dhe pa efekte anesore te renda.

Kur duhet shtyre

Quando si deve rinviare

Vaksina kunder poliomielitit duhet te shtyhet perkohesisht ne rast se femija ka nje semundje akute me ethe ose me shqetesime te pergjitheshme klinikisht te rendesishme.

Kur nuk duhet vaksinuar

Quando non si deve vaccinare

Vaksina Salk nuk duhet dhene ne rast se femija ka patur ndonjehere reaksion alergjik te rende ndaj substancave qe permbahen ne kete vaksine ose mbas marrjes se vete kesaj vaksine.

Efektet anesore

Gli effetti collaterali

Kjo vaksine durohet shume mire.

Vaksina kunder poliomielitit, sikurse çfaredo substance e huaj ndaj organizmit, mund te shkaktoje, ne raste te rralla, reaksione te caktuara alergjike.

Vaksinimi kunder difteritit dhe tetanozit

Vaccinazione contro difterite e tetano

Cfare eshte difteriti?

Che cos' è la difterite?

Difteriti eshte nje semundje infektive e rende e shkaktuar nga nje substance (toksine) e prodhuar nga nje mikroorganizem, i quajtur *Corynebacterium diphtheriae*, qe transmetohet kryesisht nepermjet pikave te peshtymes.

Kjo toksine difterike provokon demtime te renda ne shume organe midis te cilave zemra, veshket dhe sistemi nervor; krijimi ne hunde, ne gryke dhe ne laring i disa membranave dhe paralizimi i perdes se qiellzes mund te shkaktojne mbytje, zenie fryme. Rreth 5-10 raste ne 100 mund te jene vdekjeprurese edhe pse mund te jete bere nje kurim i pershtatshem.

Ne Itali, ne fillim te viteve 1900, çdo vit ne popullsine e femijeve regjistroheshin 20-30 mije raste te difteritit dhe rreth 1600 te vdekur.

Mbas venies ne veprim te vaksinimit kunder difteritit, e vendosur me ligj ne Itali ne vitin 1939, rastet e semundjes u pakesuan derisa ne vitet e fundit u bene te rastesishme. Rasti i fundit vdekjeprures ka qene ne vitin 1991 te nje femije e pavaksinuar.

Ne keto vitet e fundit, ne vendet e Europes Lindore, per shkak te nje organizimi jo te mire te fushatave te vaksinimit, ka patur mijera raste difteriti.

Cfare eshte tetanozi?

Che cos'è il tetano?

Tetanozi eshte nje semundje e rende e shkaktuar nga nje substance (toksine) e prodhuar nga nje mikroorganizem (*Clostridium tetani*) qe mund te hyje ne trup permes nje plage qofte edhe e thjeshte. Kjo toksine tetanozi shkakton tkurrje muskulare qe mund te sjellin vdekje kur prekin muskujt e frymemarrjes. Ne te gjitha rastet, pavaresisht nga terapia, kjo semundje kerkon nje shtrim te gjate ne spital, sidomos ne repartin e reanimacionit.

Ligji i vitit 1968 ka parashikuar vaksinimin e te gjithe te posalindurve duke perdorur nje vaksine kunder tetanozit shoqeruar me ate kunder difteritit.

Cdo vit ne Itali semuren nga tetanozi rreth njeqind persona te rritur, te pavaksinuar.

Vaksina kunder difteritit dhe tetanozit

Il vaccino contro la difterite e il tetano

Vaksina kunder difteritit dhe tetanozit pergatitet duke modifikuar ne menyren e duhur toksinat e tetanozit dhe difteritit ne menyre qe keto te mos mund te jene me te rrezikeshme, por ne te njejten kohe te jene te afta te stimulojne organizmin te prodhoje mbrojtje ndaj ketyre dy semundjeve.

Vaksina jepet me injeksion brendamuscular. Vaksina kunder tetanozit dhe kunder difteritit gjendet edhe ne formula te shumefishta (multiple), e shoqeruar me vaksinen kunder kolles se mire, kunder poliomielitit, kunder hemofilise, kunder hepatitit B, te kombinuara ne forma te ndryshme.

Kur duhet shtyre

Quando si deve rinviare

Ky vaksinim duhet te shtyhet perkohesisht kur femija ka nje semundje akute me ethe ose me shqetesime te pergjitheshme klinikisht te rendesishme.

Kur nuk duhet vaksinuar

Quando non si deve vaccinare

Nuk ekzistojne kushte te veçanta shendetsore qe nuk lejojne kryerjen e ketij vaksinimi, me perjashtim te rasteve kur femija ka patur ndonjehere me pare reaksion alergjik te rende ndaj substancave qe permbahen ne kete vaksine ose mbas marrjes se vete kesaj vaksine. Edhe grate shtatzena mund te vaksinohen.

Efektet anesore

Gli effetti collaterali

Kjo vaksine durohet shume mire dhe si rregull nuk shkakton reaksione.

Ka mundesi qe brenda 48 oreve mbas vaksinimit te kete nje reaksion pezmatimi kalimtar ne vendin ku eshte injektuar vaksina. Ky reaksion mund te shfaqet me enjtje, skuqje, dhembje. Mund te kete dhe temperature por jo te larte.

Disa efekte te tjera anesore si neurit (pezmatim te fundeve te nervave) mund te ndodhin rralle ne te rritur, veçanerisht nese keta kane marre nje numur te madh dozash te perseritjes se vaksines. Sidoqofte rekomandohet te mbahet gjithmone me vete libreza (apo nje çertifikate) e vaksinimeve per te shmangur kryerjen e vaksinimeve te panevojshme ne rast paraqitjeje ne Pronto Soccorso.

Sikurse çfaredo substance e huaj ndaj organizmit, ne raste te rralla, kjo vaksine mund te shkaktoje reaksione te caktuara alergjike.

Vaksinimi kunder **hepatitit B**

Vaccinazione contro epatite B

Cfare eshte hepatiti B?

Che cos' è l'epatite B?

Hepatiti B eshte nje semundje infektive ngjitese qe prek melçine dhe shkaktohet nga nje virus qe hyn ne organizem me ane te kontaktit me lengje biologjike te infektuara (gjak dhe derivatet e tij, sekrecione organike qe permbajne gjak, sperma dhe jarge te vagjines) te personave te semure ose portatore te shendoshe (te quajtur HbsAg pozitiv).

Semundja ka nje periudhe te gjate inkubacioni (45-160 dite, mesatarisht 120 dite) dhe mund te shfaqet ne forma te ndryshme; ne 65-70 % te rasteve personi nuk paraqet asnje shqetesim (forma pa sintoma). Shpesh ne femijet me te vegjel vihet re nje semundje e lehte, me nje gjendje te pergjithshme shendetsore e humori jo te mire, dobesi, dhembje gjymtyresh, te perzjera, te vjella dhe temperature me ose pa hikter, verdhez (ngjyrosje e verdhe, sarite, e lekures dhe e syve).

Rralle, veçanerisht ne moshe te rritur, nje infeksion akut mund te kete pasoja vdekjeprures.

Problemi me i rendesishem i hepatitit B eshte berja e saj kronike. Kjo ndodh me nje perseritje me shpeshtesi te ndryshme te semundjes ne mosha te ndryshme: infeksioni kronik zhvillohet ne 80% te femijeve qe ne lindje jane infektuar nga nena, e semure ose portatore e semundjes, dhe ulet deri ne 10% ne femijet me te medhenj dhe ne te rriturit. Hepatiti kronik perben nje rrezik per çirroze hepatiti dhe per tumor ne melçi. Perveç kesaj, persona me infeksion kronik perbejne nje burim te mundshem ngjitjeje te semundjes.

Vaksina kunder Hepatitit B

Il vaccino contro l'epatite B

Vaksina kunder Hepatitit B qe perdoret aktualisht permban vetem nje pjese te virusit i cili perftohet ne laborator me ane te teknikave te rafinuara te inxhinierise gjenetike dhe per kete nuk mundet absolutisht te shkaktoje semundje, por eshte e afte te krijojte imunitet kunder saj. Vaksina eshte shume e efektshme (eshte e tille me shume te femijet se te te rriturit), dhe siguron nje mbrojtje per nje kohe te gjate. Cikli i vaksinimit parashikon marrjen e tre dozave; Per femijet e lindur nga nena portatore te virusit te hepatitit B ekziston

nje kalendar i posaqem vaksinimi qe fillon qe me lindjen. Aktualisht nuk parashikohen doza te perseritjes.

Vaksina kryhet me nje injeksion brendamuskulor.

Kryerja e ketij vaksinimi eshte parashikuar ne Itali per te gjithë te porsalindurit duke filluar qe nga viti 1991. Pervec klesaj, vaksina u ofrohet falas personave qe perfshihen ne disa kategori qe per arsye profesionale (psh mjekte dhe infermiere) ose personale (psh persona qe bashkejetojne me portatore te ketij virusi, dmth HBsAg pozitive) jane veqanerisht te rrezikuar te marrin kete infeksion.

Kur duhet shtyre

Quando si deve rinviare

Ky vaksinim duhet te shtyhet perkohesisht ne rast se femija ka nje semundje akute me ethe ose me shqetesime te pergjitheshme klinikisht te rendesishme.

Kur nuk duhet vaksinuar

Quando non si deve vaccinare

Vaksina nuk u duhet dhene personave qe kane patur reaksione alergjike te renda ndaj substancave qe permbahen ne kete vaksine (psh maja e birres) ose mbas marrjes se vete kesaj vaksine me pare.

Efektet anesore

Gli effetti collaterali

Vaksina kunder hepatitit B tolerohet mjaft mire. Ne vendin e injeksionit ka mundesi te kete dhembje, skuqje dhe enjtje te perkoheshme te lehte.

Midis efekteve te pergjitheshme, shume te rralla, mund te vihen re temperature por jo e larte, dhembje koke, te perzjera, marrje mendesh, dhembje muskulare dhe gjymtyresh jo te forta dhe me nje kohezgjatje te shkurter. Akoma me te rralla kane gene shfaqje neuriti periferike vetem ne te rinj dhe te rritur.

Si cfardo substance tjeter e huaj ndaj organizmit, edhe kjo vaksine mund te shkaktoje, ne raste te rralla, disa reaksione alergjike.

Vaksinimi kunder kolles se mire

Vaccinazione contro pertosse

Cfare eshte kolla e mire?

Che cos' è la pertosse?

Kolla e mire eshte nje semundje infektive e shkaktuar nga nje bakter (Bordetella pertussis) qe transmetohet me ane te ajrit dhe qe, perpara se te fillonte zbatimi i ketij vaksinimi, shfaqej me epidemi çdo 3-4 vjet.

Shenjat e para jane te ngjashme me ato te rrufes: gjendje humori jo e mire, keputje, ngritje e lehte e temperatures, teshtitje dhe kolle, veçanerisht gjate nates. Keto shqetesime zgjasin ne pergjithesi 1-2 jave. Me pas fillojne krizat tipike te kolles, te cilat kane bere qe kjo te quhet edhe kolla "cattiva" ose "convulsiva" ose "asinina" ose "canina"). Cdo krize e kolles shfaqet me nje seri goditjesh te kolles te shpejta dhe mbytese qe veshtiresojne frymemarrjen dhe perfundojne me "ulurimen" karakteristike te frymethithjes. Shpesh kriza shkakton vjellje dhe kjo mund te demtoje edhe ushqyerjen e femijes. Kjo faze e semundjes zgjat rreth 4-6 jave dhe pasohet nga nje periudhe qetesie prej disa javesh ne te cilen krizat e kolles jane gjithnje e me te rralla dhe me te lehta. Zhvillimi i kolles se mire eshte zakonisht i mbare, edhe pse jane te mundshme disa nderlikime, si laringit, polmonit, konvulsione dhe zenie e frymes, me dem ne tru. Semundja eshte veçanerisht e rrezikshme dhe e rende ne vitin e pare te jetes, ngaqë tek i porsalinduri dhe ne moshen e gjirit kjo semundje shpesh shoqerohet me kriza te verteta mbytese dhe veshtiresi frymemarrjeje qe bejne te domosdoshem shtrimin ne spital. Perveç kesaj ne femijen e vogel jane me te shpeshta pasojat ne tru qe mund te shkaktojne deme te perhereshme, dhe, ne rastet me te renda, edhe vdekje. Sidoqofte, ne te gjitha moshat, kolla e mire sjell shqetesim te femija sepse kolla i kufizon atij mundesine e lojes dhe te levizjes, i veshtireson ushqyerjen si dhe pushimin e nates.

Vaksina kunder kolles se mire

Il vaccino contro la pertosse

Vaksina kunder kolles se mire, e quajtur edhe "joqelizor", ngaqë perbehet vetem nga disa pjese te mikroorganizmit shume te pastruara, merret me nje injeksion brendamuskulor dhe e kombinuar ne te njejten ampule me vaksina te tjera. Cikli i plote baze parashikon marrjen e tre dozave, dhe veç kesaj keshillohet edhe nje doze perseritje ne vitin e peste-gjashte dhe nje tjetër ne moshen katermbedhjete-pesembedhjete vjeç.

Vaksinimi rekomandohet që në moshën tre muajshe me qëllim që të sigurohet mbrojtja e fëmijes në vitin e parë të jetës, periudhë e një rrezikshmerie me të madhe të sëmundjes.

Kur duhet shtyre

Quando si deve rinviare

Vaksinimi kundër kolles së mire duhet të shtyhet perkohesisht në rast se fëmija ka një sëmundje akute me temperaturë ose me shqetësime të përgjithshme klinike të rëndësishme. Gjithashtu mjeku vaksinues do të vlerësojë nëse vlen që të shtyjë kryerjen e vaksinimit kundër kolles së mire edhe në rast shqetësimesh neurologjike kur shkakun i këtyre nuk është saktësuar akoma plotësisht, deri në skjarimin e problemit ose në përcaktimin e diagnozës.

Kur nuk duhet vaksinuar

Quando non si deve vaccinare

Kur fëmija është i prekur nga një sëmundje neurologjike e rëndë që mund të keqesohet me kalimin e kohës, mjeku vaksinues do të vlerësojë për çdo rast veç e veç nëse është e keshillueshme të kryhet ky vaksinim apo jo. Vakcina mund t'u jepet edhe fëmijëve që kanë kaluar "konvulsione etesh" në të kaluarën duke paralajmëruar që të mbahen nën kontroll kundër ndonjë etheje të mundshme.

Vakcina nuk u duhet dhënë personave që kanë patur reaksione alergjike të rënda ndaj substancave që përmbahen në këto vakcine ose mbas marrjes së vetë kesaj vakcine me parë.

Efektet anesore

Gli effetti collaterali

Në vendin e injeksionit mund të vihen re skuqje, enjtje dhe dhembje brenda 24-48 orëve mbas marrjes së vaksines: në përgjithësi është fjalë për reaksione të lehta dhe kalimtare. Në dy ditët e para mbas vaksinimit është e mundur gjithashtu që fëmija të ketë ethe (zakonisht të lehta, rralle temperaturë të lartë), të qara papushim edhe për tre e më shumë orë rresht, nervozizem ose gjendje gjumi. Këto reaksione të përgjithshme janë kalimtare, dhe, siç u tha, sot vihen re me rralle me përdorimin e vaksinave joqelizore. Reaksionet e përgjithëshme të konsideruara "të rënda" (psh. raste të ngjashme me kolapsin, konvulsione) konsiderohen përjashtime me vaksinat joqelizore që përdoren tani. Reaksione të tilla nuk lenë pasojë por kërkojnë një vlerësim të vemendshëm nga ana e mjekut vaksinues përpara se të vazhdojë ciklin e vaksinimit që ka komponentin kundër kolles së mire. Si çfardo substancë tjetër e huaj ndaj organizmit, edhe këto vakcine mund të shkaktojnë, në raste të rralla, disa reaksione alergjike.

Vaksinimi kunder infeksionit nga **Haemophilus Influenzae i tipit b**

Vaccinazione contro l'infezione da Haemophilus Influenzae di tipo b

Cfare eshte Haemophilus Influenzae i tipit b?

Che cos' è l' Haemophilus Influenzae di tipo b?

Ky bakter, i cili nuk duhet ngaterruar me viruset qe shkaktojne gripin dhe qe per lehtesi do ta quajme thjesht Hemofil, zakonisht gjendet ne gryke ose ne hunde ku nuk krijon asnje problem dhe transmetohet nga nje person te tjetri me ane te ajrit. Pothuajse te gjithë femijet gjate 5-6 viteve te para te jetes bien ne kontakt me Hemofilin heret a vone. Zakonisht, mbas ketij kontakti ata nuk pesojne asnje dem dhe zhvillojne antikorpset te cilat do t'i mbrojne ne jete. Megjithate, ne disa raste, Hemofili nuk mjaftohet vetem me vendosjen ne zonen e grykes, por arrin deri ne gjak, dhe, permes tij, arrin te vendoset edhe ne organe te tjera ku shkakton semundje te renda. Midis ketyre me e shpeshta eshte meningjiti. Kjo semundje eshte gjithmone e rende dhe mund te leje deme te perhereshme si shurdhesi, paralize pak a shume te rende te levizjeve, vonese mendore. Me rralle ky bakter mund te shkaktoje epiglotit (mahisje e rende dhe e papritur e pjeseve te siperme te rrugeve te frymemarrjes me sintoma mbytjeje) dhe sepsi (infeksion i perhapur ne gjak).

Keto semundje, te quajtura "forma pushtuese" prekin pothuajse vetem femijet nen moshen 5 vjeç; eshte konstatuar se ka nje rrezikshmeri me te larte per femijet qe jetojne ne bashkesi (psh. kopshte-parashkollore).

Vaksina kunder Hemofilit

Il vaccino contro l'Emofilo

Vaksina eshte i vetmi mjet per te parandaluar infeksionet "pushtuese" nga Hemofili. Kjo vaksine permban nje pjese te mikroorganizmit i lidhur me nje proteine ne menyre te tille qe eshte e afte te krijojë mbrojtje edhe te femija disa muajsh.

Vaksina eshte shume e efektshme si per evitimin e semundjes ashtu edhe per eliminimin e portatoreve, dmth femijet e shendoshe qe, mbasi jane infektuar, lejojne qarkullimin e bakterit dhe vazhdimesine e rasteve te semundjes.

Vaksina kryhet me nje injeksion brendamuskulor dhe gjendet ne forme te veçante ose e shoqeruar me vaksina te tjera.

Numuri i dozave te nevojshme varet nga mosha e femijes: ne vitin e pare te jetes jane te nevojshme 3 doza, mbas vitit te pare mjafton vetem nje doze e vetme.

Kur duhet shtyre

Quando si deve rinviare

Ky vaksinim duhet te shtyhet perkohesisht ne rast se femija ka nje semundje akute me ethe ose me shqetesime te pergjitheshme klinikisht te rendesishme.

Kur nuk duhet vaksinuar

Quando non si deve vaccinare

Nuk ekzistojne gjendje klinike qe nuk lejojne kryerjen e ketij vaksinimi me perjashtim te rasteve te personave qe kane patur reaksione alergjike te renda ndaj substancave qe permbahen ne kete vaksine ose mbas marrjes se vete kesaj vaksine me pare.

Efektet anesore

Gli effetti collaterali

Ne vendin e injeksionit mund te kete dhembje, fryrje, skuqje: dukuri zakonisht te lehta dhe qe zgjasin vetem pak kohe.

Shenja te pergjitheshme te rralla mund te jene ngritje temperature zakonisht me pak se $38.5^{\circ}C$, nervozizem i lehte dhe gjumesi.

Si çfardo substance tjeter e huaj ndaj organizmit, edhe kjo vaksine mund te shkaktoje, ne raste te rralla, disa reaksione alergjike.

Plani Kombetar per zhdukjen e Fruthit dhe te Rubeoles se lindur

Il Piano Nazionale per l'eliminazione del Morbillo e della Rosolia congenita

Fruthi eshte nje semundje qe mund te mposhtet me ane te vaksinimit te te gjitha femijeve, siç ka ndodhur ne Itali me poliomielitin, difteritin, dhe madje eshte e mundshme qe te zhduket pergjithmone, siç ka ndodhur me line. Mirepo ne Itali akoma ka epidemi periodike qe prekin femije te pavaksinuar. Epidemia e fundit e madhe ka ndodhur ne 2002, me mese 40.000 raste nga te cilet 6 te vdekur. Vezhgimi i fundit ne shkalle kombetare mbi nivelin e mbrojtjes se femijeve italiane me ane te vaksinimit (ICONA -Studim i Institutit te Larte te Shendetesise, viti 2003) ka vene ne dukje se akoma 23% e femijeve nuk vaksinohen ndaj fruthit, shytave dhe rubeoles.

Zhdukja e fruthit dhe e rubeoles se lindur perben prioritetin kryesor ne fushen e semundjeve te parandalueshme me ane te vaksinimit ne Itali.

Keshtu, gjate vitit 2003, Rajonet dhe Provincat autonome, Ministria e Shendetesise dhe Instituti i Larte i Shendetesise, se bashku me perfaqesues te pediatreve dhe punonjesve te sektorit te higjienes ne Itali jane aktivizuar per krijimin dhe zbatimin e "Planit Kombetar kunder Fruthit dhe Rubeoles se lindur". Ky plan ka si objektiv kryesor qe te beje qe te mos kete me femije qe te vdesin nga fruthi ose te lindin me deformime te renda per shkak te rubeoles se marre nga nena gjate shtatzenise.

Strategjia e vaksinimit e ketij Plani parashikon pikat e meposhteme:

- Te vaksinohen çdo vit 95% e femijeve te moshes nen 2 vjeç.
- Te vaksinohen femijet mbi 2 vjeç, te rinjte qe akoma nuk jane te mbrojtur kunder fruthit e rubeoles, si dhe te gjitha femijet qe ndjekin shkollen fillore dhe te mesme te ulet gjate viteve shkollore 2003-2004 dhe 2004-2005.
- Te futet ne perdorim doza e dyte e vaksinimit te trefishte kunder fruthit-shytave-rubeoles.

Gjithashtu parashikohen strategji qe kane si piksynim zhdukjen e rubeoles me aksione drejtuar grave ne moshen e pjellorise ose shtatzenise si dhe ndaj personelit te ekspozuar ndaj nje rreziku te larte profesional.

Ne marreveshje me sa eshte parashikuar nga Rajoni European i OBSH (Organizates Boterore te Shendetit), objektivi final i ketij Plani eshte te zhduket fruthi dhe rubeola e lindur nga Italia brenda vitit 2007.

Angazhimi i Rajoneve italiane per te arritur kete objektiv te rendesishem, duke vene ne zbatim te gjitha masat e nevojshme per suksesin e programit, si realizimi i anagrafeve te kompiuterizuara te vaksinimit, permiresimi i pergatitjes tekniko-profesionale te operatoreve te shendetesise qe merren me kete, permiresimi i mbikqyrjes se fruthit, rubeoles dhe reaksioneve ndaj vaksines, aktivizimi i fushatave te informimit dhe komunikimit drejtuar popullise, eshte sanksionuar nga marreveshja midis Shtetit dhe Rajoneve (Konferenca Shtet Rajone, vendim i 13 Nentor 2003, Gazeta Zyrtare n.297 dt. 23 dhjetor 2003).

Vaksina "e trefishte" kunder fruthit, rubeoles dhe shytave

Vaccino "triplo" contro morbillo, rosolia e parotite

Kjo vaksine perbehet nga nje kombinim ne te njejten ampule i tre grupe virusesh te gjalle dhe "te zbutur", dmth qe u jane nenshtruar modifikimeve te tilla qe i bejne ato te paafte per te shkaktuar semundje por ne te njejten kohe te afte per te nxitur prodhimin e antikorpeve te efektshem.

Perdorimi i kesaj formule "te trefishte" keshillohet per arsye te ndryshme:

- Eshte nje avantazh per femijen sepse vaksinohet njekohesisht kunder tre semundjeve me nje injeksion te vetem.
- Eshte nje avantazh per komunitetin sepse ulja e qarkullimit te virusit mbron indirekt edhe femijet e tjere me te medhenj dhe te rriturit.

Vaksinimi behet ne pjesen e siperme te krahut nen lekure.

Vaksina e kombinuar rekomandohet per te gjitha te lindurit e rinj, duke filluar qe mbas mbushjes se vitit (nga dita e 365-te e jetes e tutje). Vaksina mund te kryhet njekohesisht me vaksina te tjera (gjashtevalente, lia e dheneve).

Vaksinimi me vaksinen e "trefishte" mund tu behet edhe personave qe e kane kaluar semundjen natyrale (ndoshta edhe pa e pase vene re, siç ndodh shpesh me rubeolen dhe shytat) ose qe mund te kene qene te vaksinuar ndaj ndonjeres nga keto semundje.

Masat paraprake, kunderkeshillimet dhe efektet e mundshme anesore te kesaj vaksine jane ato te pershkruajtura ne skedat e tre vaksinave veç e veç.

Nje doze e dyte vaksine mbas disa vjetesh eshte e nevojshme per te imunizuar ata pak femije qe mund te mos kene fituar imunitet mbas vaksinimit te pare (rreth 5%).

Vaksinimi kunder

fruthit

Vaccinazione contro morbillo

Cfare eshte fruthi?

Che cos' è il morbillo?

Fruthi eshte nje semundje infektive shume ngjitese e shkaktuar nga nje virus qe transmetohet nepermjet rrugeve te siperme te frymemarrjes. Shfaqet me ethe te larta, kolle te pareshtur, rinit, konjunktivit, dhe nje prush ne lekure (ekzanteme). Femija gjithmone raskapitet nga fruthi qe me te drejte konsiderohet me e renda nga semundjet infektive "te zakoneshme" te femijerise per shkak te shenjave akute dhe te komplikacioneve te mundshme.

Keto mund te jene: otit, laringit, bronkopneumoni, piastrinopeni (pakesimi i numurit te pllakave), kriza konvulsioni dhe, mbi te gjitha, encefalit. Kjo e fundit ndodh mesatarisht ne nje rast ne çdo 1.000-3.000 femije te prekur nga fruthi dhe konsiston ne nje mahisje te rende te trurit qe mund te jete vdekje pruresë (15% e rasteve) ose mund te lere pasoja te perhershme (40% e rasteve) si: kriza konvulsioni, shurdhim dhe vonese mendore. Me rralle eshte e mundur qe nje demtim neurologjik i pakthyeshem te shfaqet 5-15 vjet mbas semundjes per shkak te nje infeksioni te vazhdueshemi lidhur me virusin e fruthit (panen-cefalite sclerosante subacuta, PEES).

Vaksina kunder fruthit

Il vaccino contro il morbillo

Vaksina kunder fruthit perbehet nga virusi i fruthit i gjalle por i debesuar ne menyre te tille qe e ben ate te paafte per te shkaktuar semundje por duke ruajtur aftesine per te nxitur prodhimin e antikorpeve mbrojtës.

Vaksina kunder fruthit mund te kryhet e vetme ose njekohesisht me ate kunder rubeoles dhe kunder shytave (vaksine "e trefishte"), ose ne kombinime te tjera; ne çfardo rasti vaksinimi behet me injeksion nen lekure ne pjesen e siperme te krahut. Formula teke e kesaj vaksine nuk gjendet gjithmone ne treg.

Vaksinimi kunder fruthit rekomandohet te kryhet qe me mbushjen e vitit te pare te jetes (dita e 365-te e tutje), njekohesisht me vaksina te tjera. Ne çfaredo rasti, ne çfardo moshe mbas vitit te pare, eshte e dobishme te behet ky vaksinim, neqoftese akoma nuk eshte marre semundja.

Vaksina eshte shume e efektshme meqenese provokon shfaqjen e antikorpeve mbrojtës ne 95% te femijeve te vaksinuar, dhe kjo perqindje eshte akoma me e larte mbas dozës se dyte Mbrojtja duket qe mbas 7-10 ditësh nga vaksinimi. Per

kete shpejtesi te veprimit te saj vaksina kunder fruthit eshte ne gjendje te parandaloje semundjen edhe mbas ngjitjes, neqoftese vaksinimi behet brenda 2-3 diteve te para mbas kontaktit te femijes me te semurin.

Kur duhet shtyre

Quando si deve rinviare

Rrethanat qe e bejne te pershtateshme shtyrjen e ketij vaksinimi jane:

- Semundje akute me ethe ose shqetesime te pergjitheshme qe konsiderohen klinikisht te rendesishme;
- Marrje kohet e fundit e imunoglobulines, gjak ose plazem, prodhime qe mund te pengojne efektin imunizues te vaksines.
- Marrje kohet e fundit e ndonje vaksine tjeter me baze virus te gjalle.

Kur nuk duhet vaksinuar

Quando non si deve vaccinare

Vaksina kunder fruthit, teke ose e kombinuar, nuk duhet te merret ne rastet e meposhteme:

- Difekt i rende i sistemit imunitar per shkak te ndonje semundjeje ose terapie.
- Reaksione te renda alergjike ndaj perberesve te vaksines (psh. neomicina ose xhelatina) ose kur ka patur reaksione alergjike te renda mbas marrjes se kesaj vaksine me pare.

Efektet anesore

Gli effetti collaterali

Vaksina kunder fruthit, si teke ashtu dhe e kombinuar me ate kunder rubeoles dhe ate kunder shytave durohet mjaft mire.

Jane te mundeshem reaksione lokale (skuqje, enjtje) ne vendin ku eshte bere injeksioni. 7-14 dite mbas vaksinimit ka mundesi qe femija te kete ngritje te temperatures, ne pergjithesi jo e larte dhe per kohe te shkurter (1-2 dite), dhe ne 5-15% te te vaksinuarve mund te arrije 39° C.

Nganjehere ka mundesi te shfaqen shenjat e nje semundjeje te zakoneshme rrufe ose te nje semundjeje te ngjashme me fruthin e zbutur, me njolla te kuqerremta ne lekure, kolle dhe skuqje te syve, qe zgjasin pak kohe dhe me nje faze akute qe perfundon shpejt e ne menyre spontane, jo ngjitese dhe qe nuk sjell komplikacione. Reaksione te keqia me te rendesishme si piastrinopenia (dmth pakesim i numurit te pllakave) jane shume te rralla dhe me ecuri te mbare. Ndersa semundja natyrale mund te sjelle pasoja te renda dhe te perhereshme.

Si çfardo substance tjeter e huaj ndaj organizmit, edhe kjo vaksine mund te shkaktoje, ne raste te rralla, disa reaksione alergjike.

Vaksinimi kunder

rubeoles

Vaccinazione contro rosolia

Cfare eshte rubeola?

Cos' è la rosolia?

Rubeola eshte nje semundje infektive e shkaktuar nga nje virus qe transmetohet me ane te ajrit.

Ne rastet kur merret mbas lindjes shfaqet si nje semundje e lehte me rrjedhe beninj qe shfaqet me temperature jo te larte, zmadhim te gjendrave linfatike (veçanerisht te atyre te qafes dhe te kokes), dhe me nje erupsion (skuqje) te lekures qe zgjasin pak kohe. Shume rralle te femijet mund te vihen re edhe hemorragji te vogla ne lekure, te te rinjte dhe te rriturit, kryesisht te seksit femer dhembje te kyçeve.

Komplikacione te rendesishme jane nje perjashtim.

Rubeola eshte nje semundje e rende nese merret per here te pare gjate shtatzenise. Ne fakt ne kete rast ekziston nje mundesi konkrete qe virusi te arrije te femija qe pritet te linde nepermjet placentes dhe te provokojë deme serioze si abortim dhe keqformim te lindur te nje rendesie te ndryshme duke prekur zemren, trurin, syte dhe degjimin.

Vaksina kunder rubeoles

Il vaccino contro la rosolia

Vaksina kunder rubeoles perbehet nga virusi i rubeoles i gjalle por i debesuar ne menyre te tille qe e ben ate te paafte per te shkaktuar semundje por duke ruajtur aftesine per te nxitur prodhimin e antikorpëve mbrojtës. Vaksinimi kunder rubeoles mund te kryhet me vete ose njekohesisht me ate kunder fruthit e kunder shytave (vaksine "e trefishte") ose ne kombinime te tjera. Ne çfardo rasti vaksinimi behet me injeksion nen lekure ne pjesen e sipërme te krahut. Formula teke e kesaj vaksine nuk gjendet gjithmone ne treg.

Vaksinimi kunder rubeoles e shoqeruar me vaksinen kunder fruthit dhe shytave rekomandohet per te gjithë femijet te kryhet qe me mbushjen e vitit te pare te jetes (dita e 365-te e tutje), njekohesisht me vaksina te tjera.

Sot vaksinohen edhe meshkujt, jo aq per mbrojtjen e tyre personale sa per te ulur sa me shume qarkullimin e virusit te rubeoles ne popullsinë dhe per ta bere akoma me te pamundur infektimin e grave shtatzena. Vaksina eshte shume e efektshme meqenese siguron nje mbrojtje mbi 95%.

Kur duhet shtyre

Quando si deve rinviare

Rrethanat qe e bejne te pershtatshme shtyrjen e ketij vaksinimi jane:

- Semundje akute me ethe ose shqetesime te pergjitheshme qe konsiderohen klinikisht te rendesishme.
- Marrje kohet e fundit e imunoglobulines, gjak ose plazem, prodhime qe mund te pengojne nje efekt te mire imunizues te vaksines.
- Marrje kohet e fundit e ndonje vaksine tjeter me baze virus te gjalle te zbutur.

Kur nuk duhet vaksinuar

Quando non si deve vaccinare

Vaksina kunder rubeoles, teke ose e kombinuar, nuk duhet te merret ne rastet e meposhteme:

- Difekt i rende i sistemit imunitar per shkak te ndonje semundjeje ose terapie.
- Reaksione te renda alergjike ndaj perberesve te vaksines (psh. neomicina ose xhelatina) ose kur ka patur reaksione alergjike te renda mbas marrjes se kesaj vaksine me pare.

Efektet anesore

Gli effetti collaterali

Vaksina kunder rubeoles tolerohet mire.

Ne nje numur te vogel te femijeve te vaksinuar (5-15%) ka mundesi te vihet re ngritje e lehte e temperatures, ndonje njolleze ne lekure dhe zmadhim i gjendrave limfatike te qafes 5-12 dite mbas marrjes se vaksines.

Shume rralle te femijet, me shpesh te te rinjte dhe grate e rritura, mund te shfaqen dhembje gjymtyresh 1-3 jave mbas vaksinimit, gje e cila zgjat per pak kohe.

Akoma me rralle jane konstatuar artrite kronike ne persona te rritur.

Si çfardo substance tjeter e huaj ndaj organizmit, edhe kjo vaksine mund te shkaktoje, ne raste te rralla, disa reaksione alergjike.

Vaksinimi kunder

shytave

Vaccinazione contro parotite

Cfare jane shytat?

Cos' è la parotite?

Shytat, qe zakonisht quhen edhe " orecchioni", eshte nje semundje infektive e shkaktuar nga nje virus qe transmetohet me ane te ajrit.

Ato shfaqen kryesisht me nje zmadhim perpara veshit i shkaktuar nga mahisja e nje gjendre te peshtymes te quajtur parotide ne njeren ose ne te dy anet. Mund te zmadhohen edhe gjendra te tjera te peshtymes dhe shpesh shfaqen njekohersisht edhe dhembje koke, ethe pak a shume te larta dhe dhembje barku.

Rendesia e kesaj semundjeje rrjedh nga komplikacionet e saj te mundshme: meningo-ençefalit, demtim ne organin e degjimit, ne pankreas, dhe, mbas pubertetit, orchite dhe ovarite (mahisje e testikujve dhe vezeve) me rrezik steriliteti.

Vaksina kunder shytave

Il vaccino contro la parotite

Vaksina kunder shytave perbehet nga virusi i gjalle por i debesuar ne menyre te tille qe e ben ate te paafte per te shkaktuar semundje por duke ruajtur aftesine per te nxitur prodhimin e antikorpave mbrojtes.

Vaksina kunder shytave mund te kryhet e vetme ose njekohesisht me ate kunder fruthit dhe kunder rubeoles (vaksine "e trefishte"). Ne te dy rastet vaksinimi behet me injeksion nen lekure ne pjesen e siperme te krahut. Formula teke e kesaj vaksine nuk gjendet gjithmone ne treg.

Vaksinimi kunder shytave e shoqeruar me vaksinen kunder fruthit dhe rubeoles rekomandohet per te gjithë femijet te kryhet qe me mbushjen e vitit te pare te jetes (dita e 365-te e tutje), njekohesisht me vaksina te tjera. Sidoqofte vaksina mund te merret ne çfardo moshe dhe vaksinimi i nje personi qe eshte tashme i imunizuar (si pasoje e nje vaksinimi te meparshem ose si pasoje e kalimit te kesaj semundjeje) nuk krijon problem.

Kur duhet shtyre

Quando si deve rinviare

Rrethanat qe e bejne te pershtatshme shtyrjen e ketij vaksinimi jane:

- Semundje akute me ethe ose shqetesime te pergjitheshme qe konsiderohen klinikisht te rendesishme.
- Marrje kohet e fundit e imunoglobulines,gjak ose plazem, prodhime qe mund te pengojne nje efekt te mire imunizimi te vaksinës.
- Marrje kohet e fundit e ndonje vaksine tjeter me baze virus te gjalle te zbutur.

Kur nuk duhet vaksinuar

Quando non si deve vaccinare

Vaksina kunder shytave,teke ose e kombinuar,nuk duhet te merret ne rastet e meposhteme:

- Difekt i rende i sistemit imunitar per shkak te ndonje semundjeje ose terapie.
- Reaksione te renda alergjike ndaj perberesve te vaksinës (psh. neomicina ose xhelatina) ose kur ka patur reaksione alergjike te renda mbas marrjes se kesaj vaksine me pare.

Efektet anesore

Gli effetti collaterali

Efektet anesore te vaksinës kunder shytave jane te rralla:disa dite mbas vaksinimit ka mundesi qe femija te kete nje zmadhim te lehte te gjendres se shytave dhe temperature per nje kohe te shkurter, shume shume rralle mahisje ne cipen e trurit me zhvillim beninj.

Si çfardo substance tjeter e huaj ndaj organizmit, edhe kjo vaksine mund te shkaktoje, ne raste te rralla, disa reaksione alergjike.

Vaksinimi kunder infeksionit nga

pneumokoku

(Streptococcus pneumoniae)

Vaccinazione contro l'infezione da pneumococco

Cfare eshte pneumokoku?

Cops' è lo pneumococco?

Eshte nje bakter shume i perhapur dhe mund te jete i pranishem pa dhene shenja ne gryke dhe ne hunde te femije dhe persona te rritur te shendoshe. Pneumokoku transmetohet nga personi ne person me rruge frymemarrjeje nepermjet kontaktit te afrimit. Ka shume tipa te ndryshem (sierotipa) te ketij mikrobi, te dalluar me ane te nje numuri. Disa prej tyre permenden me shume si shkaktare ne ndonje rast kur mikrobi pushton gjakun (semundje "pushtuese") dhe provokon semundje te renda dhe madje edhe vdekje. Pneumokoku eshte edhe nje nga shkaqet e sepsit (i njohur edhe si infeksion i gjakut per shkak te perqendrimit masiv te mikrobeve dhe prodhimeve te tyre toksike, gjendje e cila mund te perbeje nje rrezik te rende) si edhe te meningjtit (infeksion i membranave qe veshin trurin), semundje gjithmone shume e rende qe mund te lere deme te perhereshme si kriza konvulsive, shurdhesi, paralize motorike, vonese mendore. Cdo vit ne Itali konstatohen 1 deri 3 raste meningjiti nga pneumokoku per çdo 100.000 femije nen moshen 5 vjeç.

Ky bakter mund te shkaktoje edhe semundje te tjera si pneumoni, otit, sinusit. Ne raste te veçanta pneumokoku eshte treguar rezistent edhe ndaj antibiotikeve te perdorimit te zakonshem. Grup moshat me te rrezikuara nga semundja "pushtuese" jane femijet 0 deri 5 vjeç dhe te rriturit mbi 64 vjeç.

Vaksinat kunder pneumokokut

I vaccini contro lo pneumococco

Vaksinat kunder pneumokokut jane i vetmi mjet per te parandaluar semundje si meningjiti dhe infeksionet e gjakut (septicemi) nga pneumokoku. Ato munden te parandalojne disa otite, meqenese infeksionet e veshit mund te kene shkaqe te ndryshme dhe per pasoje vaksinat kunder pneumokokut jane te efektshem vetem kunder nje pjese te vogel te otiteve.

Vaksinimi eshte shume i rekomanduar dhe falas per femijet (dhe gjithashtu per te rinjte dhe te rriturit) qe jane me te kercenuar nga semundje te renda te shkaktuara nga pneumokoku per shkak te problemeve shendetesore si anemia falciforme dhe talassemia, asplenia funksionale ose anatomike (dmth funksionim i pamjaftueshem ose mungese e shpretkes), bronkopneumopati kronike, gjendje qe shoqerojne renien e imunitetit, shqetesime kardiovaskolare kronike, diabeti mellito, insufigence e veshkeve, semundje

hepatiti kronik (cirroze), humbje e lengjeve trunoshpinor. Ne Rajonin tone vaksinimi kunder pneumokokut u ofrohet falas edhe te gjithë te lindurve mbas 01.01.2006.

Ka dy lloje vaksinash kunder pneumokokut, qe te dy te perbere vetem nga pjese te mikroorganizmit dhe te quajtur te shume-vlefshem (multivalente) meqenese mbrojne kunder disa (siero)tipave te pneumokokut.

Vaksina kunder pneumokokut conjugato merret me rruge brendamuskulore. Numuri i dozave te nevojshme varet nga mosha e fillimit te ciklit te vaksinimeve.

Vaksina kunder pneumokokut polisakaridik (23 valent) merret me rruge nenlekure dhe brendamuskulor dhe eshte e mjaftueshme nje doze e vetme. Mbrojtja fillon 2-3 jave mbas vaksinimit. Mund te rekomandohet nje rivaksinim, 5 vjet mbas te pares, per personat te cilet vazhdojne te kene rrezikshmeri te larte. Femijet qe jane vaksinuar me vaksinën kunder pneumokokut coniugato si persona me rrezikshmeri te larte eshte e nevojshme te vaksinohen edhe me vaksinën 23 valente (jo perpara se te kene kaluar 8 jave nga vaksinimi i meparshem) mbas mbushjes se moshes 2 vjeçare. Te femijet me moshe me te vogel se 24 muaj perdoret vakcina coniugato. Te femijet me moshe mbi 5 vjet perdoret vakcina polissacaridico me 23 perberes.

Ne moshen ndermjet 2 dhe 5 vjeçare keshillohet te merret vakcina coniugato (nje doze).

Kur duhet shtyre

Quando si deve rinviare

Ky vaksinim, si te tjerat, duhet te shtyhet perkohesisht kur femija ka nje semundje akute me ethe ose me shqetesime te pergjitheshme klinikisht te rendesishme.

Kur nuk duhet vaksinuar

Quando non si deve vaccinare

Nuk ekzistojne kushte te veçanta shendeteore qe nuk lejojne kryerjen e ketij vaksinimi, me perjashtim te atyre personave qe kane patur ndonjehere me pare reaksion alergjik te rende ndaj substancave qe permbahen ne kete vaksine ose mbas marrjes se vete kesaj vaksine.

Efektet anesore

Gli effetti collaterali

Ne vendin e injeksionit mund te shfaqet dhembje, fryrje, skuqje telehta e per nje kohe te shkurter. Shenja te pergjitheshme mund te jene ngritje temperature, ne pergjithesi nen 38.5 °C, nervozizem i lehte dhe gjumesi, humbje e perkoheshme e oreksit. Si çfardo substance tjeter e huaj ndaj organizmit, edhe kjo vaksine mund te shkaktoje, ne raste te rralla, disa reaksione alergjike.

Vaksinimi kunder infeksionit nga

meningokoku

(Neisseria meningitidis)

Vaccinazione contro l'infezione da meningococco

Cfare eshte meningokoku?

Cos' è il meningococco?

Meningokoku eshte nje bakter qe gjendet mjaft shpesh ne gryke dhe ne hunde ku zakonisht nuk krijon asnje problem. Ka tipa te ndryshem (sierotipa) te ketij mikrobi te dalluar me nje shkronje alfabeti. Transmetimi behet nga personi ne person nepermjet sperklave te frymemarrjes. Ne disa raste meningokoku arrin ne gjak dhe, permes tij, ne organe te tjere, duke shkaktuar semundje pushtuese, veçanerisht meningjitin ose sepsin (infeksion i perhapur ne gjak). Keto semundje jane gjithmone te renda dhe mund te lene deme te perhereshme te tipit neurologjik dhe te sjelljes ose mund te çojne ne vdekje. Me pak te shpeshta jane semundje te tjera te meningokokut si pneumonia dhe koniunktiviti.

Semundja prek veçanerisht femijet me te vegjel se 5 vjeç dhe eshte me e shpeshte te femijet nen dy vjeç. Nje grup moshe tjeter qe preket nga kjo semundje, edhe pse me rralle, eshte ajo e adoleshenteve dhe e te rriturve te rinj. Ne Itali semundjet pushtuese nga meningokoku jane me te rralla se sa ne vendet e tjera, veçanerisht ne krahasim me vendet anglosaksone.

Vaksina kunder meningokokut

Il vaccino contro il meningococco

Vaksinimi eshte mjeti me i mire per te ulur rrezikun e vdekjes dhe te demtimeve te perhereshme qe rrjedhin nga nje infeksion me meningokok i shkaktuar nga sierotipat A, C, Y, W-135, ndersa per sierotipin B, qe sebashku me sierotipin C jane ata qe qarkullojne me shume ne vendin tone, nuk ekziston vaksine. Vaksinimi rekomandohet veçanerisht per femijet (si dhe per te rriturit) me aspleni funksionale dhe anatomike, dmth me funksionim te pamjaftueshem ose mungese te shpretkes.

Ne Rajonin tone vaksinimi kunder meningokokut u ofrohet falas edhe te gjithete lindurve mbas 01.01.2006.

Vaksinat kunder meningokokut jane te dy tipave, te ashtuquajturit "koniugato" dhe "lipopolisakaridiko", dhe qe te dy permbajne pjese nga mikroorganizma te modifikuara ne menyre te pershtateshme. Vaksina koniugato eshte shume e

efektshme kunder nje sierotipi te meningokokut ("grupi C", nga me te perhapurit ne Itali) dhe mund t'u jepet edhe femijeve nen dy vjeç; vaksina polisakaridike mund te perdoret vetem mbi moshen dy vjeç dhe eshte e efektshme kunder 4 (siero)tipave te meningokokut (A, C, Y, W-135).

Vaksina kunder meningokokut C koniugato jepet ne rruge brendamuskulore dhe siguron nje mbrojtje per nje kohe te gjate; numuri i dozave te nevojeshme ndryshon ne vartesi te moshes ne te cilen ka filluar cikli i vaksinimeve.

Vaksina kunder meningokokut kater-valent polisakaridiko jepet ne nje doze te vetme, vetem mbas moshes 2 vjeç. Kjo vaksine jepet ne rruge nen lekure dhe siguron nje mbrojtje te kufizuar ne kohe.

Kur duhet shtyre

Quando si deve rinviare

Ky vaksinim, si te tjerat, duhet te shtyhet perkohesisht kur femija ka nje semundje akute me ethe ose me shqetesime te pergjitheshme klinikisht te rendesishme.

Kur nuk duhet vaksinuar

Quando non si deve vaccinare

Nuk ekzistojne kushte te veçanta shendeteore qe nuk lejojne kryerjen e ketij vaksinimi, me perjashtim te atyre personave qe kane patur ndonjehere me pare reaksion alergjik te rende ndaj substancave qe permbahen ne kete vaksine ose mbas marrjes se vete kesaj vaksine.

Efektet anesore

Gli effetti collaterali

Ne vendin e injeksionit mund te shfaqet dhembje, fryrje, skuqje te lehta e per nje kohe te shkurter.

Shenja te pergjitheshme mund te jene ngritje temperature, ne pergjithesi nen 38.5 °C, nervozizem i lehte dhe gjumesi, dhembje koke, te qara, te vjella, diarre, mungese oreksi dhe dhembje muskujsh.

Si çfardo substance tjeter e huaj ndaj organizmit, edhe kjo vaksine mund te shkaktoje, ne raste te rralla, disa reaksione alergjike.

Vaksinimi kunder lise se dheneve

Vaccinazione contro varicella

Cfare eshte lia e dheneve?

Cos' è la varicella?

Lia e dheneve eshte nje semundje infektive, mjaft ngjitese, e shkaktuar nga nje virus qe transmetohet me ane te kontaktit direkt me plaget e lekures ose me ane te frymemarrjes. Ajo shfaqet ne pergjithesi me temperature jo shume te larte, gjendje te pergjitheshme shendeti e humori jo te mire dhe me nje ekzanteme tipike, qe karakterizohet nga puçra te vogla ngjyre roze qe shfaqen me vrull per 3-4 dite ne kraheror, ne fytyre, ne gjymtyre, por edhe ne goje, ne pasdalje, ne vagine dhe ne veshe. Keto puçra japin kruarje te forta dhe zhvillohen ne flluska, ne puçra me qelb dhe ne fund ne kore kokrrizore qe me pas bien. Ne disa raste keto shenja mund te shoqerohen nga nje kolle e forte.

Komplikacionet te femijet nuk jane shume te shpeshta. Neqoftese lia e dheneve merret ne fillim te nje shtatzenie mund te shkaktoje keqformime ne fetus (plage ne sy, ndryshime ne gjymtyre, vonese mendore), ndersa nese merret ne ditet e fundit te shtatzenise mund te shkaktoje nje forme shume te rende te lise se dheneve te nena dhe femija, me rrezik vdekje.

Te personat qe kane nje sistem imuniteti jo te mire dhe, ne nje mase me te vogel, te adoleshentet dhe te rriturit, lia e dheneve zhvillohet ne forme me te rende, me rrezik komplikacionesh ne mushkeri dhe ne sistemin nervor me te larte sesa te femijet.

Nje shfaqje e vonuar e infeksionit (herpes zooster) vihet re ne 15 raste semundjesh nga 100, per shkak te ngulmimit te virusit ne nyjet nervore; nje rrezik i tille rritet me rritjen e moshes.

Vaksina kunder lise se dheneve

Il vaccino contro la varicella

Il vaccino contro la varicella perbehet nga virus i gjalle e i zbutur. Mund te merret mbas mbushjes se moshes 1 vjeç. Ne Rajonin tone vaksinimi kunder lise se dheneve keshillohet dhe u ofrohet te gjithe te lindurve mbas 01.01.2006, adoleshenteve qe nuk e kane kaluar me pare kete semundje dhe rekomandohet me shume force per te rriturit me rrezikshmeri. Parashikohet nje doze e vetme kur kryhet ne moshat deri ne 13 vjet, dhe dy doza neqoftese kryhet mbas kesaj moshe. Vaksina jepet nen lekure.

Kur duhet shtyre

Quando si deve rinviare

Rrethanat qe e bejne te pershtateshme shtyrjen e ketij vaksinimi jane:

- Semundje akute me ethe ose shqetesime te pergjitheshme qe konsiderohen klinikisht te rendesishme;
- Marrje kohet e fundit e imunoglobulines, gjak ose plazem, prodhime qe mund te pengojne nje efekt te mire imunizimi te vaksines;
- Marrje kohet e fundit e ndonje vaksine tjeter me baze virus te gjalle te zbutur.

Kur nuk duhet vaksinuar

Quando non si deve vaccinare

Vaksina kunder lise se dhenve nuk duhet te merret ne rastet e meposhteme:

- Difekt i rende i sistemit imunitar per shkak te ndonje semundjeje ose terapie.
- Reaksione te renda alergjike ndaj perberesve te vaksines ose kur ka patur reaksione alergjike te renda mbas marrjes se kesaj vaksine me pare.

Efektet anesore

Gli effetti collaterali

Vaksina kunder lise se dhenve pergjithesisht tolerohet mire. Reaksionet per shkak te vaksines jane te lehta (skuqje e fryrje ne vendin e injeksionit); 6-12 dite mbas vaksinimit ka mundesi qe femija te kete ngritje temperature, pergjithesisht jo shume e larte dhe qe zgjat pak kohe, qe ne 5-15% te te vaksinuarve mund te arrije ne 39 °C.

Ne 5 % te te vaksinuarve mund te kete shperthim, prush te lekures por te lehte.

Ne kete rast ka mundesi qe personi i vaksinuar, edhe pse rralle, te jete ngjites.

Si çfardo substance tjeter e huaj ndaj organizmit, edhe kjo vaksine mund te shkaktoje, ne raste te rralla, disa reaksione alergjike.

Neqoftese shfaqet ndonje efekt anesor i rendesishem qe ka lidhje me vaksinën drejtohu te sherbimi i vaksinimeve dhe te mjeku juaj.

Disa keshilla te dobishme... neqoftese mbas vaksinimit:

Qualche consiglio utile... se dopo la vaccinazione:

- femija juaj nuk eshte i qete

il tuo bambino è irrequieto

Mbas vaksinimit femijet mund te jene te paqete sepse kane dhembje ne vendin e injeksionit ose kane temperature. Ne kete rast mund t'u jepet nje ilaç, "paracetamol", qe ndihmon per te lehtesuar dhembjet dhe per te ulur temperaturen.

- femija juaj ka kemben ose krahun te nxehte, te enjtur ose te skuqur

il tuo bambino ha la gamba (o il braccio) calda, gonfia o arrossata

Ne piken e injeksionit kamba ose krahu mund te skuqen ose te enjten. Per te lehtesuar keto shqetesime mjafton te vihet nje pece e paster dhe e fresket mbi vendin e skuqur dhe ku ka dhembje, neqoftese mendoni se femija ka shume dhembje dhe bezdiset kur e prekni sado lehte mund t'i jepni paracetamol.

- femija juaj ka temperature

il tuo bambino ha la febbre

Neqoftese mbas vaksinimit te duket se femija eshte i nxehte dhe i skuqur matja temperaturen. Keshillohet te matet temperatura ne pasdalje; temperatura nen sqetull eshte zakonisht me e ulet dhe me pak e besueshme.

Neqoftese femija ka temperature:

- jepi te pije me bollek
- vishe lehte pa e mbuluar me shume seç duhet
- beji nje banjo me uje te vaket (jo te ftohte)
- jepi paracetamol (jo acid-acetilsalicidico) neqoftese temperatura shkon mbi 38,2°-38,5° (38,7°-39° e matur ne pasdalje).

DOZA TE PARACETAMOLIT

dose di paracetamolo

per t'u dhene çdo 4-6 ore

| Pesha e femijes (kg) | Suposta (mg) | Pika | Shirup (ml) |
|-------------------------|--|-------------------------------|---|
| 5-10 11-22 mbi 23 | 1 cope 125 1 cope 250 1 cope 500 | 3 pika per çdo kg peshe | $\frac{1}{2}$ ml per çdo kg peshe |

Disa site internet te dobishme per
me shume informacion:

www.ministerosalute.it

www.simi.iss.it

www.levaccinazioni.it

www.pediatria.it

LE VACCINAZIONI NELL' INFANZIA

botim i katert

Dokument informues per prinderit

- 2006 -

Venezia, prill 2006

Lejohet riprodhimi i plote ose i pjeseshem i ketij dokumenti
por jo me qellim perfitimi, duke cituar burimin.

Iniciative botuese e programit Rajonal
"Controllo e sorveglianza malattie infettive"
(D.G.R. Veneto n. 3568 dt. 21.12.2001),
Koordinuar nga Drejtoria Rajonale per Parandalimin
dhe nga Ndermarrja ULSS 7 -Pieve di Soligo (TV)

GenitoriPiù

"Campagna per la promozione della salute nei primi anni di vita
Prevenzione attiva e vaccinazioni" Regione Veneto
DGRV n. 4403 dt. 30.12.2005 - DGRV n. 2043 dt. 27.06.2006

Koordinator i botimit:

Servizio Igiene e Sanità Pubblica dell'Az. ULSS 1 - Belluno

Kane bashkepunuar per revizionimin dhe perpilimin:
Rosanna Mel, Sebastiano Mancuso, Lorena Gottardello, Margherita Bellè,
Francesca Russo, Giuseppina Napoletano,
Servizio Igiene e Sanità Pubblica Aziende Regione Veneto

Antonio Ferro e Silvia Milani - Drejtoria Rajonale per Parandalimin

Gianpietro Chiamenti - Pediater i Familjes FIMP

Shtypi- Grafiche GIFIEEX - Roncade - Treviso

Ky botim u be ne 100.000 kopje